




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNA E ZUBIN POTOK PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Zubin Potok për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Zubin Potok (K.ZP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Zubin Potok, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna e Zubin Potokut në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV), në nenin 19 Raporti për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë e blera kapitale gjatë vitit 2021, në vlerë prej 248,353€ dhe pasuritë nga vitet paraprake. Në anën tjetër, ndërtesat publike, rrugët dhe toka nuk janë regjistruar në SIMFK. Po ashtu, edhe për pasuritë nën 1,000€ në vlerë 89,385€ nuk kishte regjistra kontabël në sistemin “e-pasuria” apo ndonjë platformë tjetër.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komuna e Zubin Potok kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në vitin 2021, si pasojë e vonesave në kryerjen e obligimeve në afatin e paraparë me ligj, janë bërë pagesat direkte përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore. Si rrjedhojë, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 39,995€ në emër të pagave të papaguara dhe kompensimeve të pagave në llogaritë e punëtorëve. Nga shuma totale, shpenzimet shtesë të shpenzimeve gjyqësore/përmbartuese dhe interesit ishin në vlerë 8,059€.
- B2 Komuna ende nuk mbledh të hyra nga taksat e pronës dhe lejet e ndërtimit dhe nuk ka miratuar rregullore të brendshme për tatimet, tarifat, taksat dhe ngarkesat për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Zubin Potok.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komuna e Zubin Potok është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Zubin Potok në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Zubin Potok me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Zubin Potok.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur se sistemi i kontrollit të brendshëm në komunën e Zubin Potokut në disa fusha nuk është në nivelin e duhur. Fushat për përmirësime të mundshme janë: korrigjimi i nevojshëm i informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat vjetore financiare, mbledhja e të hyrave nga tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit, regjistrimi i të gjithë pronës komunale, ndërtesave publike, toka në regjistrat kontabël të SIMFK dhe regjistrimi i pasurisë jokapitale nën 1,000€, realizimi i shpenzimeve gjyqësore përmes planifikimit adekuat buxhetor, si dhe mos funksionalizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB). Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-ve, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, nga të cilat dy (2) janë rekomandime të reja dhe pesë (5) janë përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mosregjistrim dhe mos shpalosje të pasurisë në PVF

Gjetja	<p>Rregullore e MF - Nr. 02/2013, neni 6, për menaxhimin e pasurive jofinanciare në organizatat buxhetore kërkon që secila organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe përditësojë një regjistër të pasurive jofinanciare që menaxhon. Regjistri duhet të mbahet veçmas për çdo aktiv dhe në formë të përmbledhur sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Rregullorja gjithashtu specifikon se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo-kapitale duhet të regjistrohet në e-pasuri.</p> <p>Në PFV-të e vitit 2021 Komuna e Zubin Potokut, në nenin 19 Raport për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë e blera kapitale gjatë vitit 2021, në vlerë prej 248,353€. Në anën tjetër, ndërtesat publike, rrugët dhe toka nuk janë regjistruar në SIMFK. Po ashtu, edhe pasuritë nën 1,000€ në vlerë prej 89,385€, nuk ishin regjistruar në sistemin “e-pasuria” apo në ndonjë platform tjetër. Kjo çështje është trajtuar në auditimin e vitit të kaluar dhe janë bërë rekomandimet e duhura, megjithatë nuk ka veprime konkrete në këtë drejtim.</p> <p>Menaxhmenti i komunës ka deklaruar arsyet se komuna ende nuk ka nisur procedurën e regjistrimit dhe vlerësimit të plotë të pronës që zotëron dhe për arsye të tjera administrative. Megjithatë, nga çështjet e përmendura rezulton se komuna nuk ka marrë me përgjegjësi menaxhimin e pasurisë.</p>
Ndikimi	<p>Mos regjistrimi i gjithë pasurisë e bën të vështirë për komunën menaxhimin dhe shfrytëzimin e suksesshëm të pronës për të marrë vendime racionale që do të ishin në interes të të gjithë qytetarëve. Gjithashtu, mungesa e të dhënave dhe informatave në regjistrin e pasurisë rezulton me përfaqësim të pasaktë në PFV.</p>
Rekomandimi B1	<p>Kryetari, duhet të ndërmer masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherë duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-pasuria. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€, duhet të regjistrohen.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në pagimin e faturave dhe kostot e procedurave përmbartimore

Gjetja

Sipas neneve 39.1 dhe 39.2 të ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin dhe përgjegjësitë për punën në financat publike, ZKF e një organizate buxhetore është përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë ose kërkesë e vlefshme për pagesë për mallrat dhe shërbimet e dorëzuara dhe/ose për punën e kryer për organizatën buxhetore duhet të të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata buxhetore.

Në vitin 2021, në bazë të vendimeve gjyqësore përmbartimore, Thesari ka ekzekutuar një pagesë në vlerë prej 39,995€ për kompensimin e pagave në llogaritë e punëtorëve. Nga kjo vlerë, nga kategoria paga dhe mëditje janë bërë pagesa 26,987€, ndërsa nga kategoria e investimeve kapitale 13,008€. Nga shuma totale, pagesat shtesë për shpenzime gjyqësore/përmbartimore dhe të interesit ishin në vlerë 8,059€. Pagesat janë për 11 punonjës të Qendrës së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe për tre (3) punonjës të Shërbimit Zjarrfikës.

Mos pagesa e faturave brenda afatit të përcaktuar ligjor, ka bërë që këto pagesa të kryhen përmes procedurave gjyqësore. Kjo për shkak të planifikimit të dobët nga komuna dhe mungesës së mjeteve buxhetore për të paguar shpenzimet në kohë.

Ndikimi

Planifikimi jo adekuat i shpenzimeve dhe vonesat në realizimin e pagesave ndikojnë që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore për Komunën.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pagesat të paguhen brenda afatit të përcaktuar me ligj, që pagat e punëtorëve të planifikohen në buxhet dhe që pagesat të bëhen vetëm kur komuna siguron mjete të mjaftueshme buxhetore për pagesë dhe të rrespektohen afatet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Moszbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave

Gjetja

Neni 2 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme thekson qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronë të paluajtshme. Gjithashtu, ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimin në nenet 1 dhe 2 përcakton qëllimin e lëshimit të lejeve të ndërtimit.

Komuna ende nuk filluar me mbledh të hyra nga taksat e pronës dhe lejet e ndërtimit dhe nuk ka miratuar rregullore të brendshme për tatimet, tarifat, taksat dhe ngarkesat për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ende nuk ka krijuar politika të zbatimit të ligjit dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e të hyrave

nga këto aktivitete që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit komunal.

Ndikimi

Mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, lejeve të ndërtimit, tarifave dhe taksave të tjera nga Komuna pasqyron një qasje jo serioze ndaj zbatimit të kërkesave ligjore në këtë fushë. Kjo ka ndikuar në një shkallë të ulët të realizimit të të hyrave si dhe pamundëson financimin e projekteve nga ky burim i të hyrave.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për të mbledhur të hyrat e tatimit në pronë dhe lejeve ndërtimore për të siguruar fonde nga këto të hyra. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë iniciimin për hartimin e Rregullores për tatimet, tarifrat dhe taksat, si kosto e shërbimeve komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Çështja A2 - Dobësitë në përgatitjen e PFV-ve

Gjetja

Sipas Rregullores së MF-së Nr.01/2017 për raportimin financiar vjetor të Organizatës Buxhetore, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar në Kontabilitetin e Parasë së Gjatshme, PFV duhet të prezantojnë informata të verteta dhe të sakta.

Me rastin e rishikimit të PFV-ve kemi identifikuar gabimet e mëposhtme:

- Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit hyrja e paras në LLVTH në kolonën buxheti final, Shënimi nr.11 të hyrat nga donacionet sipas SIMFK-së në vlerë 14,456€, nuk janë prezantuar;
- Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit- te kategoria e ndarjes hyrjet Grantet e përcaktuara të donatorëve sipas SIMFK-së, nuk është prezantuar shuma në vlerë 14,456€;
- Shënimi 5 Subvencione dhe transfere, buxheti final është prezantuar në vlerë 91,000€, sipas SIMFK-së duhet të ishte 117,000€;
- Shënimi 6 Shpenzimet kapitale, buxheti final në SIMFK në vlerë 755,000€ nuk është prezantuar;
- Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare, janë prezantuar në vlerë 0,00€, në sistemin e SIMFK-së nuk i kanë të regjistruara pasuritë,
- Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 euro), janë prezantuar në vlerë 0,00€; dhe
- Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara, saldoja për bartje është prezantuar 0,00€, sipas SIMFK-së është dashtë të prezantohet në vlerë 14,456€.

Përgatitja e PFV-ve nga Komuna nuk është bërë në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 01/2017 për raportim financiar. Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave gjatë auditimit, Komuna ka marrë masa (përveç çështjeve të opinionit të auditimit) dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme.

Dobësitë lidhur me përgatitjen e PFV-ve po përsëriten në vazhdimësi. Çështjet e shumta për korigjimin e tyre, siç janë listuar më lartë, tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm mbetet në nivelin jo të duhur.

Ndikimi

Paraqitja e pasaktë dhe jo e plotë e informatave financiare në PFV, ka ndikuar në pa saktësi të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë së shfrytëzuesit të synuar.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të shtojë kontrollat gjatë përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë kryer të gjitha kontrollat e nevojshme sipas draft PFV-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 1,268,883€, është shpenzuar 1,268,883€ apo 100%.

Çështja B3 - Mungesa e dëshmime për vijueshmëri në punë

Gjetja Sipas Nenit 8 të Rregullores 12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e nëpunësve publikë, “Të gjithë nëpunësit publikë janë të detyruar të jenë në punë gjatë orarit të punës. Çdo nëpunës publik regjistrohet në librin e prezencës ose në regjistrin elektronik”.

Komuna ende nuk përdorë evidencë elektronike për të punësuarit për vajtje/ardhje në punë, apo lista në të cilat nënshkruhen punonjësit për ta dëshmuar prezencën e tyre në punë.

Ndikimi Mungesa e evidencave për prezencën në punë, paraqet kontroll të dobët mbi menaxhimin e stafit dhe mundësi për pagesën e parregullt apo fiktive, të zyrtarëve që nuk respektojnë orarin.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Detyrimet e papaguara

Sipas Raportit Vjetor Financiar, totali i detyrimeve në fund të vitit 2021 ishte 129,992€. Në kategorinë e investimeve kapitale obligimet e papaguara janë në vlerë 104,474€, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime janë në vlerë 25,518€. Obligimet e mbetura do të barten për pagesë në vitin vijues.

Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e detyrimeve

- Gjetja** Sipas rregulles financiare Nr. 01/2013 / MF Shpenzimin e parasë publike, neni 24, pranimi dhe pagesa e faturave, pika 1.3. faturat duhet të protokollohen dhe të evidentohet në librin e faturave.
- Komuna nuk mban regjistër për pranimin e faturave, për të kontrolluar dokumentacionin e pranuar dhe për të menaxhuar faturat/detyrimet e pagesës.
- Kjo situatë ka ardhur si pasojë e kontrollit joadekuat mbi raportimin e detyrimeve të papaguara ndaj njësisë financiare komunale.
- Ndikimi** Dobësitë në mbajtjen e librit të protokollit për faturat e pranuar mund të rezultojnë në mungesë të identifikimit të llogarisë së pagesës.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të sigurojë mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF dhe në PFV në fund të vitit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Nga organizatat buxhetore kërkohet që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndihmon organizatën të arrijë qëllimet e saj duke aplikuar një qasje sistematike dhe disiplinore për vlerësimin e biznesit përmes planifikimit të punës së auditimit duke identifikuar dhe vlerësuar natyrën dhe nivelin e rrezikut të lidhur me çdo aktivitet të organizatës.

Çështja B5 - Mungesa e krijimit të njësisë së auditimit të brendshëm

Gjetja

Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Rregulloret QRK Nr. 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, Neni 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NJAB. Në bazë të Nenit 5. "Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre (3,000,000.00 €), funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nënparagrafëve 1.2, 1.3. dhe 1,4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje (themelimi i njësisë së përbashkët ose marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të auditimit nga një subjekt i sektorit publik ose kontraktimin e një shoqërie profesionale sipas kritereve të përcaktuara, me miratimin paraprak të MF-së).

Komuna nuk është audituar gjatë vitit 2021 dhe nuk ka paraqitur kërkesë në MFPT për nevojat e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe as ka përdorur mjete të tjera për të kryer funksionin e auditimit të brendshëm, siç përcaktohet në nenin 4 të Rregullores së QKR-së. - 01/2019.

Kjo është përsëritje vit pas viti, pasi që komuna nuk shprehë gadishmërinë që të vë në funksion aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Ndikimi

Mungesa e raporteve të auditimit të brendshëm çon në përsëritje të vazhdueshme të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, dhe menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje të identifikojë dobësitë e kontrollit dhe të përgjigjet në kohën e duhur për eliminimin e tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e mjeteve buxhetore, shpenzimet nga kategoritë ekonomike dhe mbledhjen e të hyrave. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,313,745	2,450,991	1,914,148	2,431,803	2,344,071
Grante Qeveritare - Buxheti	2,282,403	1,957,947	1,884,679	2,405,785	1,979,927
Financimi përmes huamarrjes	0	3,339	3,339	3,465	0
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	417,772	0	0	339,144
Të bartura nga viti i kaluar	0	26,134	26,130	22,553	25,000
Të hyrat vetanake	31,342	31,342	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	14,456	0	0	0

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 137,246€ ose 6%. Diferenca mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i rritjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak në vlerë prej 26,134€, të hyrave nga donacionet e jashtme në vlerë prej 14,456€, transfereve nga Fondi i Zhvillimit 417,772€, financimi i kredisë 3,339€ dhe reduktimi i granteve të Qeverisë për 324,455€.

Në vitin 2021, komuna ka shpenzuar 1,914,148€ ose 78% të buxhetit final që është një rënie prej 6% krahasuar me vitin 2020.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	2,313,745	2,450,991	1,914,148	2,431,803	2,344,071
Pagat dhe mëditjet	1,590,000	1,268,883	1,268,883	1,244,874	1,071,383
Mallrat dhe shërbimet	290,248	290,287	281,431	283,066	276,855
Komunalitë	20,000	20,000	16,582	15,461	6,451
Subvencionet dhe transferet	91,104	117,238	85,890	356,487	83,750
Investimet Kapitale	322,393	754,583	261,361	531,915	905,632

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë buxhetore janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 1,268,883€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 321,117€, dhe është shpenzuar 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit është 310,287€, ndërsa janë shpenzuar 298,013€ ose 96%.
- Buxheti final për subvencione ka qenë 117,238€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur (nga të hyrat vetanake) për 26,134€, janë shpenzuar 85,890€ ose 73%. Për realizimin e subvencioneve nga Granti Qeveritar janë shpenzuar 59,760€, ndërsa nga të hyrat e vitit paraparak janë shpenzuar 26,130€. Realizimi i buxhetit final krahasuar me vitin 2020 është ulur për 19%.
- Buxheti final për investime kapitale është 754,583€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 432,190€, me mjete nga Fondi Zhvillimor në vlerë 417,734€ dhe donacione të jashtme në vlerë 14,456€. Janë realizuar 261,361€ ose 35% e buxhetit final, që është 20% më pak se në vitin paraparak 2020. Shumica e shpenzimeve kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale 172,751 €, kanalizimeve 33,074€, objekteve arsimore 13,423€, objekteve shëndetësore 22,173€ dhe prokurimit të automjeteve zyrtare 19,940€. Për shkallën e ulët të realizimit të buxhetit kryesisht kanë ndikuar mjetet nga Fondi Zhvillimor të pa shpenzuara, të cilat janë transferuar në vitin 2021. Të hyrat nga Fondi i Zhvillimit janë ndarë për Programin e Zhvillimit Ekonomik Lokal në vlerë prej 409,000 €, Ndërtimi i Pishinave 3,864€, Ndërtimi i Shtigjeve të Atletikës 2,789€, Kompleksi Turistik Via Ferata 1,019€, Blerja pajisjeve mjekesore për qendrën shëndetësore 396.00€, Rehabilitimi i rrugëve lokale 467.00€, Qendra për sporte ujore në vlerë prej 198€. Gjithashtu, të hyrat e ndara nga donacionet prej 14,456€ nuk janë shpenzuar për realizimin e projekteve kapitale.

Si pasojë e situatës së pandemisë Covid-19, komuna ka shpenzuar 3,339€ për këtë qëllim. Miratimi i këtyre kostove është bërë nga kodi ekonomik (04) Financimi nga huamarrja, "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" i miratuar nga Qeveria në kuadër të Programit 00098 është shpenzuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Për vitin 2021, komuna ka inkasuar të hyra vetanake në vlerë prej 4,248€, të cilat janë nga taksat administrative, ndërsa komuna ende nuk mbledh të hyra nga tatimi në pronë dhe leje ndërtimi. Komuna gjithashtu ka inkasuar të hyra indirekte nga gjobat e policisë në shumë prej 34,781€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	31,342	31,342	4,248	4,995	2,226
Të hyrat jo tatimore	31,342	31,342	4,248	4,995	2,226

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2020, ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2021, një (1) rekomandim është zbatuar dhe pesë (5) ende nuk janë zbatuar, siç tregohet në grafikun 2 më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si ato adresohen, shihni Tabelën 4 (ose tabelën e rekomandimeve).

Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Zubin Potokut për vitin 2020, nuk ishte shqyrtuar në Kuvendin Komunal.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për të mbledhur të hyrat e tatimit ne prone dhe lejeve ndërtimore për të siguruar fonde nga këto të hyrave. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë iniciimin për hartimin e Rregullores për tatimet, tarifat dhe taksat, si kosto e shërbimeve komunale.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të marrë masa të nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronike, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në përputhje me kategoritë ekonomike të përshtatshme, për të mundësuar që raportimi të jetë i drejtë në PVF në përputhje me planin e kontabilitetit.	Komuna mori masa dhe zbatoi rekomandimin e ZKA-së.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherë duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-pasuria dhe raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV për vitin 2021. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€, të gjitha regjistrimet duhet të bëhen në sistemin e-pasuria.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollin lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF dhe në PFV në fund të vitit.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshme për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nebojsa Ristić, Udhëheqës i ekipit



Stana Dancetović, Anëtare e ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter Konfirmimi

SKUPŠTINA OPŠTINE ZUBIN POTOK KUVENDI KOMUNAL ZUBIN POTOK	KOMUNA E ZUBIN POTOK OPŠTINA ZUBIN POTOK MUNICIPALITY OF ZUBIN POTOK
Broj 18-05/22	
Numri	
Datum 18.05.2022	
Data	ZUBIN POTOK

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Zubin Potokut, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Srdjan Vulovic
Komuna Zubin Potok,
Data:17.05.2022.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.